



DREJTORIA JURIDIKE

RELACION

PËR SHQYRTIMIN E REZULTATIT TË VERIFIKIMIT TË PROKURORISË SË PËRGJITHSHME PËR FUNKSIONARIN PUBLIK Z. GLEDJON REHOVICA, ME DETYRË DEPUTET I KUVENDIT TË SHQIPËRISË, NË ZBATIM TË LIGJIT NR. 138/2015 "PËR GARANTIMIN E INTEGRITETIT TË PERSONAVE QË ZGJIDHEN, EMËROHEN OSE USHTROJNË FUNKSIONE PUBLIKE".

Në zbatim të ligjit nr. 138/2015 "Për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike", KQZ është organi kompetent për administrimin, verifikimin, zbatimin e ndalimeve për zgjedhjen dhe emërimin për funksionet publike si dhe përpunimin për formularin e vetëdeklarimit për subjekte si më poshtë:

- Deputetë të Kuvendit të Shqipërisë;
- Kryeministrit apo anëtarit të Këshillit të Ministrave që nuk është deputet;
- Kryetarit të bashkisë apo këshilltarit në këshillin bashkiak;
- Kandidatët e listave shumëmemërore për deputet dhe anëtar të këshillave bashkiak.

Z. Gledion Rahovica aktualisht me funksionin deputet i Kuvendit të Shqipërisë, më datë 27.04.2017, referuar ligjit nr.138/2015 "Për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike", së bashku me dokumentacionin e kandidimit ka depozituar në KQZ dhe Formularin e Vetëdeklarimit.

Nga verifikimi i të dhënave në Formularin e vetëdeklarimit të z. Gledion Rahovica, rezulton se nuk ka deklaruar asnjë të dhënë në lidhje me dënim me vendim të formës së prerë nga autoritete gjyqësore shqiptare apo të huaja, dënime me vendime jo përfundimtare nga autoritete gjyqësore shqiptare apo të huaja, masa sigurimi personal, urdhër ndalimi ndërkombëtar, ndalime nga organet ligjzbatuese, dëbime apo hetime brenda dhe jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë.

Në zbatim të ligjit nr.138/2015 "Për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike" dhe Kreut V, pika 2, germa b dhe pikës 3, germa c, të vendimit të Kuvendit nr.17/2016 "Për përcaktimin e rregullave të detajuara mbi zbatimin e ndalimeve të parashikuara në ligjin nr.138/2015", KQZ me shkresën nr. 2432 prot., datë 30.04.2017, ka kërkuar informacion nga zyra e gjendjes gjyqësore, për verifikimin e të dhënave për funksionarët publikë që kanë dorëzuar formularët e vetëdeklarimit në KQZ.

Në përgjigje të shkresës nr. 3687/1 prot., datë 02.05.2017, nga ana e zyrës së gjendjes gjyqësore është dërguar verifikimi i gjendjes gjyqësore për të gjithë funksionarët publikë që kemi kërkuar, nga ku rezulton se subjekti vetëdeklarues z. Gledjon Rehovica është i padënuar. Përgjigjja nga Zyra e Gjendjes Civile për këtë funksionar publik nuk ka ardhur akoma në KQZ.

Duke qene se z. Gledion Rahovica ka qenë deputet dhe në legjislaturën e kaluar të Kuvendit (viti 2009-2013), KQZ në zbatim të dispozitave të ligjit 138/2015 "Për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike" ka bërë verifikimin e të dhënave në formularin e vetëdeklarimit për këtë funksionar publikë.

Referuar shkresës nr. 3240/3 prot., datë 12.07.2016 të Drejtorisë së Përgjithshme të Gjendjes Civile, rezulton se z. Gledjon Rehovica në cilësinë e deputetit nuk ka kryer ndryshime në gjenealitetet e tij.



Prokuroria e Përgjithshme me shkresën nr. 93/2, datë 09.02.2017, i ka kërkuar KQZ-së verifikimin e të dhënave të deklaruara në formularin e vetëdeklarimit për z. Gledion Rahovica.

Pas verifikimit të formularit në përputhje me nenin 15, pika 1 të ligjit 138/2015 dhe Kreu VI, pika 6 Kreu V, pika 3, germa b e Vendimit të Kuvendit 17/2016, KQZ me shkresën nr. 118/1 prot., datë 14.02.2017 vendosi t'ia kaloj rastin për kontroll të thelluar Prokurorisë së Përgjithshme, për funksionarin publik z. Gledion Rehovica, me detyrë Deputet i Kuvendit të Shqipërisë.

Me shkresën nr.93/5 prot., datë 26.12.2017 Prokuroria e Përgjithshme, Drejtoria e Mardhënieve Juridiksionale me Jashtë, Sektori i Verifikimit të Integritetit, ka dërguar në KQZ vendimin e rezultatit të Verifikimit në zbatim të ligjit 138/2015 për z. Gledjon Rehovica me funksion deputet i Kuvendit të Shqipërisë.

Sektori i Verifikimit të Integritetit në Prokurorinë e Përgjithshme me shkresën nr. 454/2 prot., datë 17.02.2017 i është drejtuar me kërkesë Prokurorisë së Përgjithshme të Burgjeve.

Drejtorja e Përgjithshme e Burgjeve me shkresën nr. 679/1 prot., datë 27.02.2017 ka vënë në dispozicion Dëshminë e Gjëndjes Gjyqësore nr. 11 prot., datë 23.02.2017, sipas të cilës rezulton se z. Gledjon Rehovica, është " I Padënuar" brenda territorit të Republikës së Shqipërisë.

Me shkresën nr. 93 prot., datë 09.01.2017 Sektori i Verifikimit të Integritetit në Prokurorinë e Përgjithshme i është drejtuar me kërkesë Prokurorisë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Tiranë, e cila me shkresën nr. 173 prot., datë 06.02.2017 informon se nga verifikimi i kryer në zyrën e regjistrimit penal rezulton se, kjo Prokurori në datë 09.09.2014 ka regjistruar procedimin penal nr. 6140 për veprën penale të "Mosekzekutimit pa shkaqe të përligjura të vendimit të gjykatës", parashikuar nga neni 320/a i Kodit Penal. Me vendimin e datës 09.12.2014 është vendosur pushimi i hetimeve dhe rezulton qe ndaj subjektit nuk është marrë masë e sigurimit personal.

Për një verifikim sa më të plotë dhe të saktë në zbatim të nenit 8, pika 6, të ligjit 138/2015, Prokuroria e Përgjithshme me shkresën nr. 94/4 prot., datë 20.02.2017 i ka kërkuar z. Gledjon Rehovica të depozitojë gjurmët daktiloskopike pranë Drejtorisë së Policisë Shkencore.

Me shkresat nr. 977/1 prot., datë 21.02.2017 dhe nr. 1022/1 prot., datë 27.02.2017 Drejtoria e Policisë Shkencore ka vënë në dispozicion gjurmët daktiloskopike të z. Gledion Rehovica, pasi ky i fundit është paraqitur personalisht për t'i depozituar brenda afateve ligjore.

Me shkresat nr. 158 prot., datë 10.02.2017, 158/3 prot., datë 02.03.2017, 1284/8 prot., datë 22.02.2017 Sektori i Integritetit të Prokurorisë së Përgjithshme i është drejtuar me kërkesë Drejtorisë së Policisë së Shtetit, Zyrës Qëndrore Kombëtare Interpol. Në përgjigje të kërkesës, me shkresat nr. 2001/12 prot., datë 23.03.2017, nr. 2001/34 prot., datë 09.11.2017, nr. 2001/38 prot., datë 07.12.2017 Zyra Qëndrore Kombëtare Intepol ka kthyer përgjigje se subjekti nuk ndodhet i regjistruar në databazet kriminale të disa shteteve pjesë të Intepolit.

Me shkresën nr. 2001/40 KL prot., datë 22.12.2017 Zyra Qëndrore Kombëtare Interpol informon se nga Interpol Romë, Itali pas krahasimit të gjurmëve të gishtave ka rezultuar se ndaj z. Gledion Rahovica, më datë 27.02.1999, është raportuar vepra penale "Vjedhje Dyqani", me gjeneralitete të z. Kusta Mina, lindur më datë 21.12.1978 në Shqipëri.

Subjekti rezulton se nuk e ka deklaruar këtë informacion, dhe pse ka patur detyrimin ligjor për ta pasyruar në formularin e vetëdeklarimit dhe konkretisht në pikën 3 të formularit "A keni qënë

ndonjëherë në hetim po gjykim nga një autoritet i huaj për kryerjen e një vepre penale?" dhe pikën 4 të formularit, "A keni qënë ndonjëherë i ndaluar apo i arrestuar nga organet ligjzbatuese për kryerjen e një vepre penale?". Z. Gledjon Rehovica i është përgjigjur me "Jo" të dyja pyetjeve më sipër.

Në KREUN III, pika 3, ç), thuhet se formulari (që plotësohet dhe firmoset nga subjektet vetëdeklarues) përmban një rubrikë që detyrimisht pasqyrohet se "...pasqyrimi i të dhënave të pavërteta, të paplota, dhe të pasakta në të, *passjell përjashtimin e menjëhershë dhe në çdo kohë nga kandidimi/zgjedhja/emërimi apo nga funksioni publik*".



Duke nënshkruar faqen e dytë të formularit II, "Marrja dijëni mbi efektet e formularit dhe të vetëdeklarimit", pika d) "Pasqyrimi i të dhënave të pavërteta, të paplota, dhe të pasakta në këtë formular dhe refuzimi i depozitimit të gjurmëve daktiloskopike", pasjell skualifikimin e menjëhershëm dhe në çdo kohë nga kandidimi/zgjedhja/emërimi apo ushtrimi i menjëhershëm i funksionit publik", subjekti mban përgjegjësinë e plotë dhe është i vetëdijshëm për pasojat ligjore në rast të deklarimeve të pavërteta, të paplota apo të pasakta, në lidhje me të kaluarën e tij kriminale.

Fakti që në formularin e vetëdeklarimit, nuk është pasqyruar asnjë e dhënë e përcejellë në lidhje me ndalimet dhe hetimet përkatëse në shtetin Italian, si dhe identitetin e rremë të përdorur nga vetë ai, me të cilin është dyshuar se ka konsumuar veprën penale "Vjedhje", bën që subjekti të përfshihet në kushtet e ndalimit të ushtrimit të funksionit publik si deputet i Kuvendit të Shqipërisë. Kjo pasjell përjashtimin e menjëhershëm dhe në çdo kohë nga funksioni publik që mban.

KQZ pas shqyrtimit të rezultateve të verifikimit nga Prokuroria e Përgjithshme vlerëson se për sa i përket procedurave të ndjekura për rezultatet e verifikimit në lidhje me të dhënat në formularin e deklarimit, referuar pikës 1 dhe 2 të nenit 8 të ligjit 138/2015 dhe pikës 5 të Kreut V të vendimit 17/2016 të Kuvendit të Shqipërisë, është kompetencë e Prokurorisë së Përgjithshme.

Prokuroria e Përgjithshme, ka kryer verifikimin e të dhënave dhe referuar informacionit të ardhur nga Interpol/Romë/Itali, ka konstatuar se funksionari Gledion Rahovica është raportuar për veprën penale, "Vjedhje dyqani". Duke qenë se funksionari është përgjigjur me jo pyetjes 3 dhe 4 të formularit të vetëdeklarimit "A keni qenë ndonjëherë në hetim apo ne gjykim nga një autoritet i huaj për kryerjen e një veprë penale?" dhe "A keni qenë ndonjëherë i ndaluar apo arrestuar nga organet ligjzbatuese për kryerjen e një veprë penale", rezulton se ai nuk ka deklaruar se ndaj ti ka patur hetim, ndalim, apo gjykim nga autoritetet ligj zbatuese Italiane.

Personi i cili sipas autoriteteve Italiane është raportuar për veprën penale të marrjes së mallrave të vjedhur ka përdorur të dhëna identiteti (Kusta Mina, lindur më 21.12.1978) të cilat nga analiza e gjurmëve të gishtave përputhen me të dhënat aktuale të z. Gledion Rahovica.

Nga shqyrtimi i formularit të vetëdeklarimit funksionari në rubrikën 2 të tij nuk ka deklaruar përdorimin e gjenealiteteve të tjera. Sipas rubrikës "B" të formularit funksionari publikë ka patur detyrimin të deklarojë gjeneralitet të mëparëshme të ndryshuara zyrtarisht apo që janë përdurur nga funksionari edhe pa i ndryshuar zyrtarisht.

Kreu III, pika 3, gërma ç parashikon "Formulari i vetëdeklarimit përmban detyrimisht një rubrikë ku pasqyrohet se.... Pasqyrimi i të dhënave të pavërteta të paplota dhe të pasaktanë të pasjell përjashtimin e menjëhershëm dhe në cdo kohë nga kandidimi/zgjedhja/emërimi apo nga funksioni publik.

Prokuroria e Përgjithshme pasi ka konstatuar se verifikimi është kryer i plotë dhe i gjithëanshëm dhe vlerëson se funksionari referuar gërmës c, pikës 3, Kreut III të vendimit të Kuvendit nr.17/2016, është në kushtet për ndalimin e ushtrimit të funksionit.

Referuar nenit 10, pika 1, gërma d, kur verifikohen kushtet për moszgjedhje apo moskandidim KQZ shpall pavlefshmërinë e mandatit dhe përfundimin e parakohshëm të mandatit të funksionarit publik. Gjithashtu referuar nenit 5, pika 3, të ligjit deklarimi i rrethanave të rreme ose të shtrembëruara përbën veprë penale, sipas nenit 190 të Kodit Penal.

Në këto kushte funksionari publik ka paraqitur rrethana apo të dhëna të rreme në formularët e vetëdeklarimit. Formularët e vetëdeklarimit ja kanë drejtuar Komisionit Qendror të Zgjedhjeve.

Konkretisht me veprime aktive, z. Gledion Rahovica, deputet i Kuvendit të Shqipërisë, ka konsumuar elementët e veprës penale të "Falsifikimi ose përdorimi i vulave, i stampave apo i formularëve të



falsifikuar ose paraqitja e rrethanave të rreme në këto të fundit, që u drejtohen organeve shtetërore, dënohet me burgim nga gjashtë muaj deri në katër vjet”, parashikuar nga neni 190 i Kodit Penal.

Dëshira PASKO – Drejtoria Juridike

Ylli MERKAJ – Sekretar i Përgjithshëm i KQZ-së

